



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 76, DATË 03.09.2020

**MBI  
SHQYRTIMIN E NDRYSHIMEVE TË NDODHURA NË STRUKTURËN E  
PRONËSISË TË SHOQËRISË “FAX MEDIA NEWS” SH.A., LICENCUAR PËR  
SUBJEKTIN AUDIOVIZIV “FAX NEWS”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “Fax Media News” sh.a.

Objekt: Mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Fax Media News” sh.a., licencuar për subjektin audioviziv “Fax News”.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 i ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

**VËREN SE:**

Shoqëria “Calvin Vizion Tv” sh.a., është autorizuar të funksionojë si operator televiziv lokal privat në fushën e transmetimeve tokësore analoge me vendimin nr. 23/22, datë 23.10.2000, të Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit (sot AMA). Me vendimin nr. 322, datë 07.03.2005, të KKRT-së është vendosur rinovimi i licencës. Me vendimin nr. 706, datë 16.07.2008, të KKRT-së është vendosur miratimi i ndryshimeve në kuotat e pronësisë dhe kalimi i tyre tek ortaku i vetëm me 100% të aksioneve, Z. Ahmet Muçaj. Me vendimin nr. 781, datë 25.02.2009, të KKRT-së është vendosur ndryshimi i emrit nga “Tv Calvin” në “Planet Televizion”. Me vendimin nr. 193, datë 12.11.2010, të KKRT-së është vendosur rinovimi i licencës. Me vendimin nr. 124, datë 08.06.2016 të AMA-s, këtij subjekti i është rinovuar dhe zëvendësuar licenca. AMA, me vendimin nr. 228, datë 12.10.2016, ka vendosur miratimin e kërkesës së shoqërisë “Planet Televizion” sh.a., licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Planet Televizion” mbi ndryshimet e ndodhura në këtë subjekt, duke kaluar kuotat nga z. Ahmet Muçaj, aksionar me 100% të aksioneve të z. Gentjan Xhemalaj, aksionar me 100% të



aksioneve). Me vendimin nr. 207, datë 25.10.2017, AMA, mbi kërkesën e subjektit ka miratuar ndryshimin e emrit të shoqërisë në "Fax Media News" sh.a., dhe emrit të subjektit audioviziv në "Fax News". AMA me vendimin nr. 136, datë 04.10.2019, ka pajisur këtë subjekt, me licencë shërbimi programi audioviziv për të ofruar shërbim në qarqet Tiranë-Durrës.

Me shkresën nr. 81 prot., të datës 19.04.2018, administruar në AMA, me nr. 1918 prot., datë 26.04.2018, shoqëria "Fax Media News" sh.a., licencuar për subjektin audioviziv "Fax News", ka njoftuar për ndryshime të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë duke kaluar 90% të aksioneve, të z. Gentian Xhemalaj (aksionar me 100% të aksioneve) tek shoqëria "Kedo Group" sh.p.k. dhe 10% të aksioneve tek z. Ardian Dushaj.

Në vijim të njoftimit të shoqërisë "Fax Media News" sh.a., AMA me shkresat nr. 1918/2 prot., datë 06.07.2018 dhe nr. 498 prot., datë 25.01.2019, ka kërkuar plotësimin e njoftimit me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), të shoqërisë "Fax Media News" sh.a., si dhe të shoqërisë "Kedo Group" sh.p.k. (dokument origjinal ose fotokopje e noterizuar);
- Kontratën noteriale të shitjes së aksioneve (dokument origjinal ose fotokopje e noterizuar);
- Vërtetim mbi eksperiencat e punës së aksionarëve të rinj të shoqërisë "Fax Media News" sh.a., vërtetim prej institucioneve tatimore dhe/ose sigurimeve shoqërore mbi kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat etj, të derdhura në favor tyre;
- Të dhëna zyrtare mbi burimet financiare të aksionarëve të rinj të shoqërisë "Fax Media News" sh.a.;
- Depozitimin e vërtetimeve të gjendjes gjyqësore të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të aksionarëve të shoqërisë "Fax Media News" sh.a. (dëshmitë e penalitetit).

AMA vëren se është ndryshuar plotësisht struktura e pronësisë së shoqërisë së pajisur me licencë transmetimi nga autoriteti, pasi është larguar aksionari ekzistues duke kaluar aksionet në aksionarë të rinj. AMA, si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve audiovizive, ka si detyrim të kontrollojë dispozitat e zbatimit të ligjit të posaçëm nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ndërkohë, rezulton se subjekti jo vetëm që nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë por gjithashtu nuk ka kryer pagesën në masën 50,000 lekë, në zbatim të vendimit të AMA-s nr. 220, datë 01.12.2017 "Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive".

Sa më sipër, AMA arrin në përfundimin se kërkesa e subjektit duhet të rrëzohet,

### **PËR KËTO ARSYE**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "Fax Media News" sh.a., për miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë.

2. Ngarkohet administrata e AMA-s për vijimin e komunikimit me shoqërinë “Fax Media News” sh.a., lidhur me ndryshimet e pronësisë së subjektit dhe vijimin e procedurës për rikthimin në gjendjen e mëparshme të strukturës së pronësisë së subjektit.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Gentian SALA**

**Zëvendëskryetar:**

**Sami NEZAJ**

**Anëtarë:**

**Agron GJEKMARKAJ**

**Gledis GJIPALI**

**Suela MUSTA**